

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”
NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË
ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri:	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Adresa:	Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë
Tel/Faks:	Tel. +355 42 362 627 Fax. +355 42 363 644
E-mail:	QSUT@shendetesia.gov.al

Adresa e ueb-faqes:	www.qsut.gov.al
---------------------	-----------------

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Admirlan Bici

E-mail admirlan.bici@qsut.gov.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e hapur - Shërbime – Prokurim me mjete elektronike – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj”

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuader: Shërbim - Me një operator ekonomik (ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

5. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-80205-11-26-2020

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Shërbim Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi 50000000-5

8. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 111,688,382 (njëqind e njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

Për modifikimin e kontratës së shërbimit, autoriteti kontraktor QSU “Nënë Tereza” u bazuar në nenin 127(1), gërma “c” të LPP, duke arsyetuar si më poshtë vijon:

Sjellim në vëmendje se neni 127, në paragrafin e parë, gërma “c” parashikon se “1. Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedure të re prokurimi në rastet e mëposhtme: c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër.”

AK QSUNT me shkresën nr. 443/13 prot., datë 28.08.2023 drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, ka kërkuar interpretim dhe këshillim ligjor për sa vijon: “...minikontrata në zbatim të marrëveshjes kuadër është në fuqi, a gjen zbatim neni 127 i LPP, duke modifikuar kontratën, ose marrëveshjen kuadër (në rastin kur kjo marrëveshje kuadër është në fuqi) pa zhvilluar më parë një procedurë prokurimi, me kusht që modifikimi të mos kalojë vlerën prej 20% të kontratës, apo të fondit limit me të cilin është lidhur MK? Në rast se po, cila është procedura që duhet të ndjekë AK për modifikimin e Kontratës/Marrëveshjes Kuadër? Gjithashtu lutem vlerësoni mundësinë e këshillimit nëse përlllogaritja bëhet duke iu referuar 20% të vlerës së marrëveshjes kuadër apo përlllogaritja bëhet duke ju referuar 20% e vlerës së kontratës (minikontrata në zbatim të marrëveshjes kuadër)?”

Në përgjigje të kërkesës së sipërcituar, me shkresën nr. 6703/1 prot., datë 31.08.2023 “kthim përgjigje”, të Agjencisë së Prokurimit Publik, administruar në QSUNT me nr. 443/15 prot., datë 31.08.2023, na bëhet me dije se përlllogaritja e vlerës 20% të modifikimit duhet t’i referohet vlerës

së kontratës konkrete që është në zbatim, e lidhur brenda marrëveshjes kuadër.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit me këtë objekt, për nga kompetenca lëndore i takon Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara (VKM nr. 393/2022, Kreu III, pika 1/j). Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në cilësinë e AK përfitues, ka marrë të gjitha masat për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi, duke dërguar në kohë nevojat e saj pranë ASHPP për këtë objekt prokurimi, ku fillimisht, përcjellja e nevojave për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje objekti ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj” me REF-80205-11-26-2020, për prokurim pranë ASHPP është bërë me shkresën nr. 2589/20 prot., datë 07.12.2022 “Përcjellje dokumentacioni”.

Duke marrë shkasë nga paragrafi i mësipërm, përmendim se në shkresën nr. 6543/1 prot., datë 31.08.2023 “Kthim përgjigje”, të Agjencisë së Prokurimit Publik, administruar në QSUNT me nr. 443/14 prot., datë 31.08.2023, citohet; “(...); mosrealizimi në kohë i procedurave, sjell problematika në mosplotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktore, si dhe në përdorimin e procedurës së prokurimit ‘negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës’, si një procedurë jokonkurrese dhe jo transparente.”

Nga QSUNT në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet shkresave si dhe në rrugë elektronike, i është kërkuar vazhdimisht ASHPP-së informacion për fazën në të cilën ndodhet zhvillimi i procedurës së përcjellë, apo informacion mbi afatin e parashikuar deri në lidhjen e marrëveshjes kuadër, e pasqyruar ndër të tjera edhe në kërkesën nr. 443/16 prot., datë 31.08.2023 të DSHM, ku tregohet se QSUNT nëpërmjet shkresave të njëpasnjëshme (elektronike dhe zyrtare) ka ezauruar mjetet në dispozicion për shpalljen e procedurës së prokurimit, me qëllim mbulimin e nevojave për këtë objekt.

Referuar shkresës nr. 443/16 prot., datë 31.08.2023, nëse sistemi i ujerave të zeza nuk pastrohet cdo ditë, rrjedhimisht pompat bllokohen dhe ky sistem (sistemi i pompimit nuk punon), dhe kjo situatë sjell permbytje në katet e nëntokës.

Në katin -1 të godinës A2 është instaluar kabina elektrike, transformatori dhe gjithë rrjeti elektrik kryesor i godinës dhe në rastet e mospastrimit të përditshëm ose të avarive në pusetat e ujërave të zeza spitali nuk do të ketë energji elektrike dhe nuk do të funksionojë.

Edhe zërat e tjerë të parashikuar në mirëmbajtjen ndërtimore janë të rëndësishëm për cdo lloj problematike që ndodh në shërbim (si ndërhyrje me karkater, punime lyerje, punime ,marangozi, elektrike dhe hidraulike të cilat janë punime që nuk presin në kohë.

Transferimi i shërbimeve nga një ambient në një ambient tjetër ku duhet të ndërhyhet dhe të bëhen punime ndërtimore, elektrike, hidraulike, marangozi dhe lyerje në mënyrë që shërbimi të jetë sa më cilësor dhe të jetë funksional. Përpara se të transferohen shërbimet, sikurse përmendet rasti i fundit transferimi i shërbimeve të Godinës së Kardiokirurgjisë dhe Kirurgjisë Vaskulare në Ambientet e godinës ekzistuese të 6-Katëshit. Përpara se këto shërbime të transferoheshin u kontrolluan të gjitha rrjetet elektrike, hidraulike, u bënë punime rifiniture dhe lyerje dhe u siguruan që shërbimi funksionon normalisht dhe pa probleme. E njëjta gjë ndodhi edhe me transferimin e sallave, ku u desh kapacitet i plotë në cmontimin e paisjeve mjekësore si dhe instalimin e tyre në ambientet e tjera.

Theksohet se, me modifikimin e kontratës fillestare nr. 78/4 prot., datë 17.01.2023, nuk ndryshon në thelb natyra e kontratës, e cila megjithë këtë modifikim, mbetet e llojit “Shërbim”, përmban të njëjtat kushte kontraktore, objekt shërbimi mbeten të njëjtat zëra dhe asnjëra nga palët kontraktuese nuk ndryshon / zëvendësohet.

Mbahet në konsideratë se parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik, nuk lejojnë aplikimin e një procedure standarde prokurimi, në kushtet kur kjo e fundit me Vendim të Këshillit të Ministrave kryhet në mënyrë të përqendruar nga një autoritet tjetër kontraktor, në cilësinë e OQB. Rikujtojmë parashikimet e LPP, neni 53(2), në të cilin përcaktohet në mënyrë eksplicite se “2. Këshilli i Ministrave, me kërkesën e një autoriteti ose enti kontraktor ose me nismën e vet mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet ose ent tjetër kontraktor si organ qendror blerës.”

Sikurse parashtrohet dhe argumentohet më lart, duke qenë se situata faktike nuk vjen si pasojë e sjelljes (veprimeve / mosveprimeve) së AK QSUNT, si dhe AK nuk ka mjete ligjore në dispozicion për të siguruar shërbimin me këtë objekt në kushtet kur kjo procedurë zhvillohet nga ASHPP; gjithashtu, në kuadër të parimeve të legjislacionit të prokurimit publik, autoriteti kontraktor QSUNT duhet të vlerësojë mjetet ligjore në dispozicion që të shmangë sa mundet mundësitë e përdorimit të procedurës ‘negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës’, rezulton se modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës, në përputhje me nenin 127/1/c.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:

Objekt i këtij Aneksi, është modifikimi i kontratës së shërbimit me nr. 78/4 prot., datë 17.01.2023 me objekt “Shërbim Mirëmbajtje Objekti Ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare “Nëne Tereza” – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj”, me vlerë 15,291,359.5 lekë pa TVSH dhe 18,349,631.4 lekë me TVSH, në masën 19.68 % të kësaj vlere, që i korrespondon shumës prej 3,009,890.57 (tre milion e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pik pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 3,611,868.68 (tre milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë me TVSH.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar: 15,291,359.5 (pesëmbëdhjet milion e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë pik pesë) lekë pa TVSH dhe 18,349,631.4 (tetëmbëdhjetë milion e treqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një pik katër) lekë me TVSH.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 3,009,890.57 (tre milion e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pik pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH. dhe 3,611,686.68 (tre milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë me TVSH.

13. Kohëzgjatja e kontratës: nga nënshkrimi i kontratës deri më datë 31.08.2023, me kusht që nëse vjen autorizimi nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara për lidhjen e kontratës bazë, marrëveshje kuadër për 24 muaj, kjo kontratë shkëputet menjëherë.

Dhe afati i ri (nëse është rasti): Afati për zbatimin e këtij modifikimi kontrate është: 15.11.2023 ose deri në ezaurimin e vlerës totale

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri: “R&T” sh.p.k.

NIPT: J61901094G

Adresa: TIRANE Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shk.A, Kati 10, përfaqësuar nga Administratori Kontaktet 0692054800, jorgjizallemi@yahoo.com

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 31.08.2023

16. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti kontraktor: Për autoritetin kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ky lloj shërbimi është jetik dhe AK duhet të jetë i mbuluar me këtë shërbim në mënyrë të pandërprerë. Në këto kushte, mosrealizimi në kohë i procedurave të prokurimit nga ASHPP, sjell problematika në mosplotësimin e nevojave të AK, si edhe në përdorimin e procedurës së prokurimit “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, si një procedurë jokonkurrese dhe jotransparente. Në këto kushte dhe duke patur si qëllim mos ndërprerjen e shërbimit të sipërcituar, gjendur në kushtet e emergjencës nga rrethana të paparashikueshme nga AK, është bërë modifikimi i kontratës së shërbimit.